



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA VLORE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE, TURIZMIT DHE SHËRBIMEVE
MBËSHTETËSE
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 19625 Prot

Vlorë, më 21.11 2025

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____, 2025

PËR
MIRATIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE DHE NIVELIT TË PAGAVE TË
BASHKISË, INSTITUCIONEVE TË VARËSISË DHE FUNKSIONEVE TË
DELEGUARA – 2026

Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 113, Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8 pika 2, neni 9, pika 1.1.b të Kreut III, neni 54 pika ç, d dhe dh, të Kreut IX, neni 64 pika c të Kreut X, VKM nr. 503 datë 01.08.2024 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 328, datë 31.5.2023, të këshillit të ministrave, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, VKM Nr. 326, datë 31.5.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike” dhe VKM nr. 422, datë 26.6.2024 “Për një ndryshim në vendimin nr. 326, datë 31.5.2023, të këshillit të ministrave, “për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar, pika 12 m, Ligjin nr. 10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve” neni 2, shkronja “c” dhe nenit 5, VKB nr. 101, datë 03.12.2024 “Për miratimin e nivelit të pagave të Bashkisë, Institucioneve të Varësisë dhe Funksioneve të deleguara - 2025”, VKB nr. 102 datë 18.12.2024 “Për krijimin e Ndërmarrjes së Pastrimit dhe Ndërmarrjes së Gjelbërimit në vartësi të bashkisë Vlorë dhe për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, Institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara – 2025” dhe shkresën nr. 1269/1 prot. datë 15.10.2025, hyrë në Bashki me nr. 16747 prot. datë 15.10.2025;

VENDOSI:

1. Transferimin e shërbimit dhe funksionit të “Ndërmarrjes së Gjelbërimit” në “Ndërmarrjen e Pastrimit”, si dhe mbylljen e “Ndërmarrjes së Gjelbërimit”.
2. Shërbimi i Ndriçimit Rrugor të transferohet si funksion në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike.
3. Ambjentet e ish-Gjimnazit “Shaban Demiraj” të shfrytëzohen nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

4. Të miratojë numrin e punonjësve të Bashkisë dhe institucioneve të varësisë si vijon:

- Në administratën e Bashkisë Vlorë 394 punonjës
- Konvikti (Arsimi profesional) 16 punonjës
- Çerdhet 19 punonjës
- Arsimi (Punonjës jomësitor/ mësues ndihmës dhe Inspektor QKF) 44 punonjës
- Qendra Ditore e të Moshuarve 4 punonjës
- Në Qendrën e Shërbimeve me Bazë Komunitare për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara 14 punonjës
- Në Qendrën Kulturore 30 punonjës
- Në Teatrin Petro Marko 28 punonjës
- Në Klubin Shumësportësh "Flamurtari" 17 punonjës
- Në Qendrën e Zhvillimit PAK 22 punonjës
- Qendra e Shërbimeve Mbështetëse Për Fëmijën dhe Familjen 11 punonjës
- Në Ndërmarrjen Publike për Menaxhimin e Mbetjeve Urbane 39 punonjës
- Në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike 150 punonjës
 - Sektori i Ndriçimit 15 punonjës
 - Sektori Rrugë, trotuare, plazhe, DDD 86 punonjës
 - Sektori i mirëmbajtjes së varrezave 26 punonjës
 - Bordi i Kullimit 19 punonjës
 - Rrugët rurale 4 punonjës
- Në Ndërmarrjen e Pastrimit(Pastrim, Gjelbërim) 336 punonjës

5. Të miratojë numrin e punonjësve në strukturën e Bashkisë ardhur me grant të kushtëzuar:

- Zyra e Gjendjes Civile 16 punonjës
- Arsimi parashkollor / punonjësit jomësitor (sistemi 9 vjeçar) 355 punonjës
- Arsimi i mesëm punonjes jomësitor 51 punonjës
- Sektori i MNZSH 50 punonjës

6. Të miratojë klasën dhe shtesën për pozicion të pagës për punonjësit e Bashkisë dhe Institucioneve të varësisë, si më poshtë:

Administrata e Bashkisë Vlorë

Tabela nr. 1

Pozicioni	Klasa	Shtesa për pozicion
Kryetar		290,000
Zv/Kryetar		225,000
Këshilltar	II-2	141,000
Drejtor Kabineti	I-5	170,000
Sekretar Këshilli	I-5	170,000
Sekretar kryetari/Specialist	IV-4	60,000
Administrator Rajoni	III-3	98,000
Administrator NJ.A		145,000

Drejtor i Përgjithshëm	I-5	170,000
Drejtor Drejtorie	II-2	141,000
K/Inspektor	III-2	105,000
Përgjegjës	III-2	105,000
Specialist	IV-2	80,000
Specialist	IV-3	70,000
Inspektor	IV-2	80,000
Përgjegjës	III-3	98,000 +7,500
Specialist IT	IV-2	80,000 +7,500
ND		47,000
Elektricitist		47,000
Punonjës P. Bashkiake		54,900

Çerdhet	Klasa	Shtesa për pozicion
Përgjegjës	III-3	98,000
Kujdestar	IV-4	60,000
Kujdestar		47,000
ND/MB		47,000

Konvikti (Arsimi profesional)

Tabela nr. 2

Pozicioni	Klasa	Shtesa për pozicion
Përgjegjës	III-3	98,000
Ekonomist	IV-3	70,000
Punonjës edukativ	IV-3	70,000
ND/MB		47,000

Arsimi	Klasa	Shtesa për pozicion
Mësuese ndihmese/ Inspektor QKF		
ND		47,000

Qendra e Shërbimeve me Bazë Komunitare për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara

Tabela nr. 3

Pozicioni	Klasa	Shtesa për pozicion
Drejtor	II-2	141,000
Psikolog	IV-3	70,000
Punonjës Social	IV-3	70,000
Edukatore	IV-4	60,000
Logoped	IV-3	70,000
Fizioterapist	IV-3	70,000
Pastruese		47,000

Qendra e Kulturës**Tabela nr. 4**

Pozicioni	Klasa	Shtesa për pozicion
Drejtor	II-2	141,000
Përgjegjës	III-3	98,000
Punonjës	IV-3	70,000
Punonjës	IV-4	60,000
ND/MB		47,000

Teatri Petro Marko**Tabela nr. 5**

Pozicioni	Klasa	Shtesa për pozicion
Drejtor	II-2	141,000
Përgjegjës	III-3	98,000
Punonjës	IV-3	70,000
Punonjës	IV-4	60,000
ND/MB		47,000

Klubi Shumësportësh “Flamurtari”**Tabela nr. 6**

Pozicioni	Klasa	Shtesa për pozicion
Drejtor	II-2	141,000
Financier	III-3	98,000
Specialist	IV-3	70,000
Inspektor	IV-4	60,000
ND/MB		47,000

Qendra e Zhvillimit PAK**Tabela nr. 7**

Pozicioni	Klasa	Shtesa për pozicion
Kujdestare/Edukatore	IV-4	60,000
Infermier/Logoped	IV-3	70,000
Kujdestare		47,000
ND		47,000

Ndërmarrja Publike për Menaxhimin e Mbetjeve Urbane**Tabela nr. 8**

Pozicioni	Klasa	Shtesa për pozicion
Drejtor	II-2	141,000
Përgjegjës	III-3	98,000
Specialist	IV-2	80,000
Specialist	IV-3	70,000

Specialist	IV-4	60,000
MB		47,000
ND		47,000

Qendra e Shërbimeve Mbështetëse Për Fëmijën dhe Familjen
Tabela nr. 9

Pozicioni	Klasa	Shtesa për pozicion
Përgjegjës	III-3	98,000
Psikolog	IV-3	70,000
Punonjës Social	IV-3	70,000
Kujdestare	IV-4	60,000
Kujdestare alternative		47,000
Pastruese		47,000

Ndërmarrja e Shërbimeve Publike
Tabela nr. 10

Pozicioni	Klasa	Shtesa për pozicion
Drejtor	II-2	141,000
Përgjegjës	III-3	98,000
Specialist	IV-3	70,000
Specialist	IV-4	60,000
ND/MB		47,000
Punëtor		47,000

Ndërmarrja e Pastrimit(Pastrim, Gjellbërim)
Tabela nr. 11

Pozicioni	Klasa	Shtesa për pozicion
Drejtor	II-2	141,000
Përgjegjës	III-2	105,000
Përgjegjës	III-3	98,000
Specialist	IV-2	80,000
Specialist	IV-3	70,000
Specialist	IV-4	60,000
ND/MB		47,000
Punëtor		47,000

7. a. Miratimin e shtesës për vjetërsi në punë në masën:

- 0,6% pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e para (1–10 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
- 0,8% pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e dyta (11–20 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
- 1% pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e treta (21–30 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit.

- b. Punonjësit administrativë, punonjësit mbështetës dhe punonjësit e Policisë Bashkiake përveç pagës bazë, përfitojnë shtesën për vjetërsi në punë. Kjo shtesë aplikohet në masën 1 për qind mbi pagën bazë të përcaktuar për çdo klasë. Për llogaritjen e kësaj shtese merret për bazë vjetërsia e përgjithshme në punë, por jo më shumë se 25 vjet.
8. Punonjësit e Policisë Bashkiake do të përfitojnë shtesë për vështirësi në punë 4.000 (katër mijë) lekë muaj.
9. Punonjësit mbështetës dhe punonjësit e specialiteteve do të përfitojnë shtesë për natyrë të veçantë pune në masën 4.000 (katër mijë) lekë në muaj.
10. Fondi i pagës për punonjësit e Bashkisë, Institucionet e varësisë dhe funksioneve të transferuara pasqyrohet në buxhetin e Bashkisë Vlorë 2026.
11. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
12. Ky Vendim hyn në fuqi sipas Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 55, pika 6.

KRYETAR

Brunilda Mersini





REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA VLORE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE, TURIZMIT DHE SHËRBIMEVE
MBËSHTETËSE
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 19625 prot.

Vlorë, më 21.11 2025

RELACION
PËR PROJEKTVENDIMIN “PËR MIRATIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE
DHE NIVELIT TË PAGAVE TË BASHKISË, INSTITUCIONEVE TË
VARËSISË DHE FUNKSIONEVE TË DELEGUARA – 2026”

Të nderuar këshilltarë,

Bazuar në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 8 pika 2, neni 9, pika 1.1.b, të Kreut III, neni 54 pika ç dhe dh, Kreu IX, neni 64, pika a, b, c, ç dhe d të Kreut X, është kompetencë e Këshillit Bashkiak miratimi i numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë dhe institucioneve të varësisë dhe i nivelit të pagave dhe shpërblimeve të punonjësve dhe të personave të tjerë, të zgjedhur ose të emëruar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në lidhje me projektvendimin e paraqitur në këtë mbledhje të Këshillit Bashkiak, ju informojmë se:

Për pikën 1.1. Transferimin e shërbimit dhe funksionit të “Ndërmarrjes së Gjelbërimit” në “Ndërmarrjen e Pastrimit”, si dhe mbylljen e “Ndërmarrjes së Gjelbërimit”.

Gjatë vitit 2025, shërbimi i pastrimit dhe gjelbërimit në qytet është kryer nga dy ndërmarrje, Ndërmarrja e Pastrimit dhe Ndërmarrja e Gjelbërimit, miratuar kjo strukturë me vendim të Këshillit të Bashkisë Vlorë nr. 102, datë 18.12.2024. Sipas këtij vendimi struktura për secilën ndërmarrje përbëhej nga staf administrativ dhe mbështetës 158 në pastrim dhe 130 në gjelbërim, pra në total 288 punonjës.

Në përfundim të analizës së shërbimit gjatë vitit 2025, u vu re se funksionimi i ndërmarrjeve të ndara, solli problematika në menaxhimin në terren të shërbimeve që kryente secila ndërmarrje. Konkretisht shërbimi i pastrimit mbetej i pa mbuluar në territor dhe qyteti u përball me shërbimin e pastrimit jo cilësor, dhe në pjesë të ndryshme të qytetit pothuajse nuk ofrohej ky shërbim në periudhën e sezonit turistik.

Në këto kushte, administrata e Bashkisë gjykon që këto ndërmarrje duhet të ushtrojnë veprimtarinë e tyre të bashkuara. Avantazhet që përfiton bashkia dhe qytetarët nga bashkimi i dy ndërmarrjeve në një entitet të vetëm, për shërbimin e pastrimit dhe gjelbërimit, janë si më poshtë:

Rritje e efikasitetit operacional

- Efienca e burimeve njerëzore për punëtorinë.
 - më shumë mbikëqyrës të integruar
 - një plan të unifikuar pastrimi dhe gjelbërimi
 - koordinim të përbashkët për sezonin turistik
 - shpërndarje më e drejtë e burimeve midis rajoneve, zonave turistike, zonave në periferi dhe rrugëve dytësore
- Menaxhim më i mirë i mjeteve

Më parë, mjetet ishin të ndara në 2 struktura të ndryshme gjë e cila sillte vështirësi në mirëmenaxhim, organizim dhe kosto më të lartë të shërbimit. Marrë në konsideratë që për një proces të njëjtë pune, duhet të vinin dy ndërmarrje të ndryshme.

Me bashkimin e dy ndërmarrjeve gjatë planifikimit të proceseve të punës do të mundësohet që mjetet do të vihen në shërbim të një strukture për një shërbim më cilësor dhe gjithëpërfshirës.

Në Bashkinë Vlorë(Qyteti) sipërfaqja në të cilën kryhet shërbimi i pastrimit, rrugë, sheshe, blloqe banimi është 756.000 m². Sipas standardeve europiane të pastrimit CEN/TC 330, një punëtor duhet të kryejë pastrim manual për 200 – 400 m²/orë, për 6.5 orë fshin 2600 m² sipërfaqe.

Për 756.000 m² sipërfaqe pastrim manual (fshirje) nevojiten 290 punëtorë të fshesës, për 1 turn. Duke qenë se një pjesë e këtyre hapësirave fshihen me makineri, ndërmarrjes i nevojiten rreth 130 punonjës fshese, nga 34 punonjës që janë aktualisht. Riorganizimi i ndërmarrjeve dhe rishpërndarja e burimeve njerëzore do të mundësojë plotësimin e strukturës me numrin e punonjësve që nevojiten në shërbimin e fshesës.

Për pikën 2. Shërbimi i Ndricimit Rrugor të transferohet si funksion në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike.

Shërbimi i sektorit të ndricimit rrugor do të transferohet nga Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike, për këto arsye:

- a. Shfrytëzimi efikas i mjeteve që administron aktualisht sektori i ndricimit me gërshtimin e mjeteve të vet Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike.
- b. Shfrytëzimi më efikas i fuqisë punëtore të sektorit të ndricimit rrugor dhe të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike në shërbimin e ndricimit dhe anasjelltas.
- c. Kryerja në të njëjtën kohë e mirëmbajtjes dhe kthimit në gjendjen e mëparshme të trotuareve dhe rrugëve pas ndërhyrjes së punimeve të ndryshme për ndricimin rrugor.

Për pikën 3. Ambjentet e ish-Gjimnazit “Shaban Demiraj” të shfrytëzohen nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Bazuar në Urdhërin nr. 56 datë 04.02.2025 “Për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar publik, gjimnazi Shaban Demiraj, Vlorë”, godina në kushtet aktuale nuk kryen asnjë funksion. Duke marrë në konsideratë funksionet e ndryshme që kryen Ndërmarrja e Shërbimeve

Publike, numrin e mjeteve dhe materialeve, nevojiten ambjente të reja për këtë Ndërmarrje. Për këtë arsye propozojmë që Ndërmarrja e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të shfrytëzojnë këto ambjente.

Për pikën 4. Të miratojë numrin e punonjësve të Bashkisë, institucioneve të varësisë dhe strukturën e ardhur me grant të kushtëzuar si vijon:

• Në administratën e Bashkisë Vlorë	394 punonjës
• Konvikti (Arsimi profesional)	16 punonjës
• Çerdhet	19 punonjës
• Arsimi (Punonjës jomësitor/ mësues ndihmës dhe Inspektor QKF)	44 punonjës
• Qendra Ditore e të Moshuarve	4 punonjës
• Në Qendrën e Shërbimeve me Bazë Komunitare për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara	14 punonjës
• Në Qendrën Kulturore	30 punonjës
• Në Teatrin Petro Marko	28 punonjës
• Në Klubin Shumësportësh “Flamurtari”	17 punonjës
• Në Qendrën e Zhvillimit PAK	22 punonjës
• Qendra e Shërbimeve Mbështetëse Për Fëmijën dhe Familjen	11 punonjës
• Në Ndërmarrjen Publike për Menaxhimin e Mbetjeve Urbane	39 punonjës
• Në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike	150 punonjës
– <i>Spektori i Ndriçimit</i>	15 punonjës
– <i>Spektori Rrugë, trotuare, plazhe, DDD</i>	86 punonjës
– <i>Spektori i mirëmbajtjes së varrezave</i>	26 punonjës
– <i>Bordi i Kullimit</i>	19 punonjës
– <i>Rrugët rurale</i>	4 punonjës
• Në Ndërmarrjen e Pastrimit(Pastrim, Gjelbërim)	336 punonjës
• Zyra e Gjendjes Civile	16 punonjës
• Arsimi parashkollor / punonjësit jomësitor (sistemi 9 vjeçar)	355 punonjës
• Arsimi i mesëm punonjes jomësitor	51 punonjës
• Spektori i MNZSH	50 punonjës

Në këtë projektvendim po paraqesim kërkesën për rritjen e numrit të punonjësve bazuar në analizën funksionale të njësive strukturore dhe nevojave të konstatuara në terren. Ky ristrukturim ka si qëllim shpërndarjen e burimeve njerëzore dhe materiale të Bashkisë për të kryer me më shumë efikasitet shërbimet dhe funksionet e përcaktuara në Ligj.

Në administratën e Bashkisë do të ketë një riorganizim të burimeve njerëzore. Qëllimi kryesor është fuqizimi i Njësive Administrative dhe plotësimi i organikës me të gjithë stafin e nevojshëm për ofrimin e shërbimit më pranë komunitetit bazuar në parimin e subsidiaritetit sipas Ligjit “Për vetëqeverisjen vendore”. Ky riorganizim nuk sjell rritje të numrit total të punonjësve, por shpërndarjen e tyre nga ndërmarrjet e varësisë në Njësitë Administrative, të cilat janë pjesë e Administratës.

Është parashikuar rritje e numrit të punonjësve të Policisë Bashkiake me qëllim kontrollin më të mirë të territorit, menaxhimin eficient të situatave problematike dhe garantimin e rendit dhe sigurisë në komunitet. Kompetencat e përcaktuara në Ligjin nr. 89/2022 “Për Policinë Bashkiake” në shërbim të sigurisë, qetësisë dhe rendit në komunitet, mbarëvajtjes së punëve publike, miradministrimit të hapësirave publike dhe mbrojtjes së mjedisit në territorin e juridiksionit, kanë sjellë nevojën për rritjen e numrit të punonjësve.

Në analizën e kryer nga grupi i punës është evidentuar një rritje graduale e numrit të fëmijëve që kërkojnë mbështetje individuale në arsimin parashkollor. Për këtë arsye kërkohet rritja e numrit të mësuesve ndihmës, e parashikuar në këtë projektvendim.

Ndërmarrja e Pastrimit është një nga strukturat me ngarkesën më të lartë operacionale, për shkak të rritjes së sasisë së mbetjeve si pasojë e aktivitetit turistik, zgjerimit të zonave të banuara, nevojës për turne të plota dhe vështirësisë në përballimin e shërbimeve si pastrimi në fshesë i territorit. Me ristrukturimin e ndërmarrjes synohet përmirësimi i ofrit të shërbimit, rritja e frekuencës së pastrimit në zonat problematike dhe përmirësim i përgjithshëm i cilësisë higjienës publike. Shtimi i punonjësve në këtë ndërmarrje është një domosdoshmëri funksionale për të garantuar një shërbim modern, eficient dhe të qëndrueshëm të pastrimit në Bashki.

Nivelet e pagave të përcaktuara në këtë projektvendim nuk ka ndryshim nga niveli i pagave i miratuar në vitin 2025, bazuar në VKM-në nr. 503 datë 01.08.2024 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 328, datë 31.5.2023, të këshillit të ministrave, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”.

Në këto kushte, Bashkia Vlorë i drejtohet Këshillit Bashkiak me këtë Projekt-Vendim “Për miratimin e numrit të punonjësve dhe nivelit të pagave të Bashkisë, Institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara – 2026”.

Ju faleminderit!

